



AVOKAT - LAWYER
HAJZER SALIHU, NR. LICENCËS 2081/2021

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINË
-Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil -

Paditësi: Fehmi Geci, i lindur me 31.12.1963 ne fsh. Llaushë, K. Skenderaj dhe me vendbanim ne rr. "Imer Berisha", p.n Klinë, me nr. personal 1013391927 të lëshuar nga MPB e R. Kosovës, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. Hajzer Salihu me adresë në rr. "Fehmi Agani" Hy.154, Kati 1, nr.8, 10000 Prishtinë;

I padituri: Faton Peci, Ministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, adresa rr. Ukshin Hoti-Kompleksi "Ramiz Sadiku", 10000 Prishtinë;

Vlera e kontestit: 45,000.00 €

Bazuar ne nenin 17 paragrafin 1 të Ligji Nr.02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, si dhe nenit 252 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore, ne afatin ligjor parashtrojmë këtë:

PADI
KUNDËR SHPIFJES DHE FYERJES

1.PËRSHKRIMI FAKTIK:

Me datë 12.09.2024, i padituri Faton Peci, në cilësinë e Ministrit ne foltoren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke i'u përgjigjur pyetjes së deputetes znj. Mirlinda Tishukaj-Sadiku, ka shpifur dhe fyer për personalitetin e paditësit Fehmi Geci, kur ka deklaruar se: *"Projekti për inventarizimin e tokave bujqësore ne vlerë prej 1.4 milion euro është një ndër projektet me abuzive dhe flagrante që une kam gjetur ne Ministrine e Bujqësisë,si rezultat i veprimeve që unë i kam ndërmarrë si Minsitër, por edhe mekanizmat e drejtësisë, aktualisht ish Drejtori i Institutit të Bujqësor është i suspenduar dhe me aktakuzë të ngritur e bashkë me të edhe 3 zyrtarë të tjerë për shkak të abuzimit flagrant që kanë bërë me këtë projekt"*. Kjo deklaratë shpifëse dhe fyese, përveç që është transmetuar 'live' nga seanca e Kuvendit të Republikës së Kosovës me dt.12.09.2024, e njëjta është shpërndarë edhe ne web-faqen e facebook-ut të Levizjes Vetvendosje

Provë: Deklarata e të paditurit, e konvertuar në formatin CD;

Linku - <https://www.facebook.com/share/v/mmWwsKTj9E2EP3Tt/?mibextid=xfxF2i>

Me dt.01.10.2024, paditësi përmes "Kërkeses me nr. protokolli 374", drejtuaar të paditurit dhe e protokolluar në Minsitrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të paditurit i kërkon që ta demantojë deklaratën e tij, dhe të bëjë kërkim falje publike lidhur me deklarinimin shpifës dhe fyese të bërë ne foltoren e Kuvendit ndaj paditësit, duke i dhënë prova të mjaftueshme të cilat i'a vërtetojnë se asgjë nga ato që ai kishte deklaruar lidhur me paditësin nuk ishte e bazuar ne fakte dhe prova, si dhe njëkohësisht e paralajmëron që ne rast të mos demantimit të kësaj shpifje të bërë nga ai, si dhe kërkim faljes publike, lidhur me çështjen paditësi do të ndjek rrugët tjera ligjore, gjegjësisht përmes ushtrimit të mjeteve juridike do ti drejtohet gjykatës kompetente.

Provë: Kërkesa me nr. protokolli 3747, dt.01.10.2024;

SHKELJET LIGJORE:

Deklaratat e dhëna nga i padituri të përshkruara si më lartë, bien ndesh me Ligjin Nr. 02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, pasi që si rezultat i kësaj deklarate të pa bazuar në fakte dhe prova, i padituri i ka shkaktuar dëm të pariparushëm emrit të mirë dhe imazhit të paditësit, si dhe reputacionit të zyrtarit dhe qytetarit të ndershem që njihet në vendin ku jeton dhe punon, imazh ky qe është ndërtuar me punë të zellshme e të mundimshme nga përvoja e tij shumëvjeçare në institucione të ndryshme.

Ky Ligj ka për qëllim të rregullojë përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje duke siguruar: c) *Kompensime efektive dhe të përshtatshme për personat të cilëve u është dëmtuar reputacioni nga shpifja dhe fyerja.* Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes, në nenin 3 e definon shpifjen dhe fyerjen si në vijim: *"Shpifja-nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmtton reputacionin e një personi tjetër"*, kurse *"Fyerja-nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese"*.

Lidhur me këtë, ashtu sic është përshkruar me lartë, përmbajtja e deklaratës se dhënë nga i padituri me datën 12.09.2024, e cila është shpërndarë edhe në rrjete sociale të facebook dhe faqen Youtube, padyshim bie nën definicionin e shpifjes dhe të fyerjes, ashtu sic e parashohin normat ligjore, dhe kjo deklaratë si e tillë përbën fyerje pasi që nënçmon personalitetin dhe e dëmton rëndë reputacionin e paditësit. Neni 6 i këtij ligji qartë e përcakton se në kontestet për shpifje dhe fyerje, *i padituri do të ketë barrën e provave për të dëshmuar vërtetësinë e deklaratës së tij*. Aq më shumë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim: GJEDNJ) në çështjen *Koprivica vs Mali i Zi*, 41158/09, të datës 22 nëntor 2011, ka konstatuar se: *"i padituri duhet të provojë/dëshmojë se pretendimet e ngritura nga ai janë të vërteta"*. GJEDNJ-ja, po ashtu në çështjen *Bladet Tromso vs Norvegjisë*, 21980/93, të datës 20 maj 1999, ka konstatuar se *"sa më serioze është akuza, aq më solide duhet të jetë baza faktike"*.

I padituri ka shpifur dhe fyer rëndë, kur nëpërmjet deklaratës së tij ka shpifur se *"...ish Drejtori i Institutit të Bujqësor (këtu paditësi) është i suspenduar dhe me aktakuzë të ngritur e bashkë me të edhe 3 zyrtarë të tjerë për shkak të abuzimit flagrant që kanë bërë me këtë projekt.."*, e që për këto akuza nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme, dhe as që ekziston ndonjë fakt, apo provë që do ta dëshmonte një gjë të tillë. E vërteta e kësaj çështje rezulton të jetë krejt ndryshe nga deklarimi i të paditurit, respektivisht se lidhur me këtë projekt z. Fehmi Geci nga NJHKEK -Prishtinë, ka qenë i ftuar ne cilësi të dëshmitarit e jo të të dyshuarit. Madje tutje nga provat që paditësi disponon, rezultojnë se edhe kallëzimi penal ndaj të apostrofuarve të tjerë i ngritur lidhur me çështjen e *"Projektit për inventarizimin e tokave bujqësore"*, është hedhur poshtë nga Prokuroria e Shtetit-Prokuroria Themelore Pejë, me Aktvendimin PP/I.nr.199/2022 të dt.28.08.2024, duke vendosur se: *"Nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se kanë kryer veprën penale për të cilën janë dyshuar"*.

Provë: Aktvendimi i Prokurorisë Themelore Pejë me shenjë PP/I.nr.199/2022 të dt.28.08.2024;

Thirrje për Dëshmitarin Fehmi Geci, e dt.10.11.2023 nga Njësia NJRHKEK Prishtinë;

Duke mos pasur asnjë bazë, por vetëm për qëllime të ulëta dhe konsum ditorë politik, si dhe duke dashur që të forcoj pozitën e tij ne opinionin publik, fjalori i tij fyes, shpifës dhe denigrues, pa pasur bazë ne asnjë provë të besueshme, ka dëmtuar rëndë dinjitetin, nderin dhe reputacionin e paditësit.

3. BAZA LIGJORE E KËRKESËS

3.1 Ligji Nr.02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes-LCKSHF

LCKSHF-ja në nenin 14 dhe 15 e saktëson mundësinë e kërimit të kompenzimit të dëmit jomaterial për shpifje dhe fyerje si dhe të përcaktimit të përgjegjësisë për të njëjtat. Në rastin konkret, përmbajtja e deklaratës se të paditurit asesi nuk mund të bie në kuadër të kornizave të përjashtimit të përgjegjësisë sipas dispozitave të LCKSHF-së, pasi që i njëjti e ka ditur fare mirë, ose është dashur ta dijë se përmbajtja e atyre akuzave është e pabazë dhe e rrejshme, por me dijeni dhe vullnetin e plotë i ka thënë të njëjtat për aritjen e qëllimeve të tija politike.

3.2 Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve

Sipas nenit 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), dëmi ndër të tjera është edhe shkaktimi tjetrit i vuajtjes psikike (dëmi jo material). Sipas nenit 136 të LMD-së, kush i shkakton tjetrit dëm, detyrohet ta kompenzojë atë.

Poashtu, sipas nenit 183, par. 1 dhe par.2 i LMD-së, për dhembjet e pësuar shpirtërore, cenimin e autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, gjykata pasi të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla. Gjatë marrjes së vendimit lidhur me këtë lloj të dëmshpërblimi, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe për qëllimin të cilit i shërben ky shpërblim.

Përmes deklaratës publike të të paditurit, paditësit i është shkaktuar dhimbje shpirtërore dhe stres të intenzitetit të lartë, dhimbje e cila është e vazhdueshme dhe në rritje e sipër, për sa kohë që deklaratat e dhëna janë të qasëshme në procesverbalin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, rrjetet e internetit (google, facebook, youtube.), si dhe ne arkivin e mediave elektronike dhe të shkruara.

Denigrimi i personalitetit përmes deklaratave shpifëse dhe fyese është vështirë të kompenzohet, pasi që reputacioni ose integriteti personal është ajo çfarë e identifikon individin, dhe si i tillë është reflektim i arritjeve të tij jetësore. Reputacioni ose integriteti personal është vlera më e madhe që e posedon individi, e rrjedhimisht cenimi i kësaj vlere paraqet një ndër shkeljet më të mëdha që mund t'i bëhet njeriut. Në këtë rast, kompenzimi material paraqet një lloj satisfaksioni për paditësin ndaj të cilit është shpifur dhe i cili është fyer jashtë mase me përmbajtjen e deklaratave shpifëse dhe fyese.

Paditësi konsideron se i padituri me përmbajtjen shpifëse dhe fyese të deklaratës së tij, i ka shkaktuar dëm jashtëzakonisht të madh jomaterial, vlera e të cilit do të mund të përcaktohet sipas parimit të çmuarjes së lirë nga gjykata.

Po ashtu në bazë të nenit 186 të LMD-së, për përcaktimin e vëllimit të shkaktuar, gjykata duhet të caktojë edhe shpërblimin që i padituri do t'ia kompensojë të paditësit për fitimin e humbur, pasi që nga kjo deklaratë denigruese dhe shpifëse e të paditurit, ka dërguar edhe në krijimin e ambientit të përshtatshëm politik për mos kthimin e tij në vendin e punës.

Duke u bazuar në arsyet e cekura më lart, paditësi i propozon gjykatës që pas administrimit të provave dhe shkresave të lëndës, të vendos në meritë dhe të nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Fehmi Geci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Hajzer Salihu nga Prishtina.

II. OBLIGOHET i padituri që në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për dëmtim të reputacionit, të shkaktuar me deklaratën e tij, si dhe dëmit të ardhshëm, paditësit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 45,000.00 euro (katerdhjetë e pesë mijë euri), në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim e ekzekutimit me dhunë.

III. OBLIGOHET i padituri që paditësit t'ia paguajë të gjitha shpenzimet procedurale si dhe shpenzimet e përfaqësimit, sipas Rregullores për Tarifën e Odës së Avokatëve.

Prishtinë, 22.10.2024,

Parashtruesi i padisë sipas autorizimit:

Hajzer Salihu, Avokat

